



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i procesverbalit të mbledhjes së katërt të Komitetit për Barazi Gjinore, mbajtur më 29.11.2022, duke filluar në orën 16:00.

Në mbledhje morën pjesë: anëtarët e komitetit: Violeta Salihu, Besart Krasniqi, dhe Leonora Shabani - Bajraktari.

Mungoi: Gëzim Mehmeti dhe Dhurata Jahaj - Retkoceri.

E pranishme ishte edhe Premtime Preniqi, koordinatore për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Violeta Salihu, kryesuese e komitetit dhe propozoi këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Barazi Gjinore;
2. Diskutim lidhur me mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme në kuadër të "16 ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore";
3. Të ndryshme.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Barazi Gjinore

Kryesuesja konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë të Komitetit për Barazi Gjinore.

Pika e dytë

Diskutim lidhur me mbajtjen e seancës së jashtëzakonshme në kuadër të "16 ditë aktivizim kundër dhunës me bazë gjinore"

Violeta Salihu, kryesues tha se sot patëm një mbledhje me kryesuesin e Kuvendit Fehmi Kupinën, për shkak të temës, si do ta bëjmë këtë temë për me diskutuar lidhur me fushatën **“16 ditë aktinizëm kundër dhunës në barazi gjinore”**, dhe **“Raportim i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje”**, tema të cilat do të jenë për diskutim në mbledhjen e jashtëzakonshme. Për këto tema do të kemi një koordinim me drejtorin e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale me kryetarin dhe nënkryetaren e Komunës. Po ashtu diskutimet do të vazhdojnë edhe nga përfaqësuesit e grupeve parlamentare, apo edhe nga të tjerët.

Premtime Preniqi, tha se në diskutim e sipër me Violeten, kryesuese e komitetit u pajtuam që në mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit, për pikën: *“Raportimi i mekanizmit koordinues kundër dhunës në familje”*, si koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, do të raportoj para anëtarëve të Kuvendit. Duke pasur parasysh se shumica e anëtarëve të Kuvendit nuk e dinë kur u themelua mekanizmi, çfarë funksione ka edhe kush është në atë mekanizëm, pra dhe duhet ditur se kur u themelua, kush janë akterët, sfidat, mundësit, ku këto gjera i kamë përshkruara në pika të shkurta. Po ashtu kam bërë disa statistika të vogla dhe shihet se kohëve të fundit ka rritje të dhunës në familje.

Violeta Salihu, kryesuese tha se të gjitha këto që u cekën nga znj. Preniqi, ndoshta mundet me qenë një ndër rekomandimet që a duhet me u ndarë një buxhet për mekanizmin, por mendoj se kjo duhet të bëhet në përputhje me Planin e veprimit që e ka bërë ministria përkatëse-Qeveria.

Po ashtu edhe dhuna në institucione mundet me u zvogëluar shumë, si ajo fizike, psikike apo dhuna seksuale në vendet e punës, kështu që dhuna mund të jetë si dhunë në familje, dhe ne nuk mundemi me thënë se kanë probleme vetëm këta që kanë vështirësi ekonomike, por dhuna është e evidente edhe të kategoritë tjera të shoqërisë si ajo e njerëzve me famë, kështu që dhuna nuk po njihet as status social, as gjini, as moshë, as profesion edhe është në rritje e sipër.

Leunora Shabani- Bajraktari, kërkoi nga znj. Preniqi që rekomandimet që kanë të bëjnë me këtë çështje të prezantohen në këtë komitet dhe më pas kryesuesja e komitetit ti paraqet në Kuvend para anëtarëve të Kuvendit.

Premtime Preniqi, propozoi që të jenë këto dy rekomandime:

1. Të ndahen mjete buxhetore, jo të krijohen kode,
2. Të bëhet mbështetja e projekteve me fokus në luftimin e dhunës në familje.

Po ashtu tha se këto ditë jemi në organizim e sipër të një fushate në shesh në bashkëpunim edhe me strehimoren, ku do të vendosim një tendë dhe aty do të ekspozohen disa punime nga gratë të cilat janë në strehimore.

Violeta Salihu, kryesuese lidhur me këtë fushatë tha se duhet me vazhduar mbështetja për strehimoret në vazhdimësi.

Leunora Shabani-Bajraktari, shtroi pyetje se a bënë ne me kërkuar rritjen e numrit të strehimoreve, a është e duhur kjo në qoftë se ne kërkojmë me u ndërtuar edhe një strehimore tjetër.

Premtime Preniqi, tha se kjo është regjionale, më e lehtë është me e kërkuar një strehimore, me e bëre secila komunë për vete.

Violeta Salihu, sa i përket krijimit të strehimoreve të tjera tha se kjo është temë shumë delikate është problem, kërkon buxhet dhe staf profesional, duhet pasur licencim të mirëfilltë, staf të trajnuar etj.

Po ashtu ceku se sa i përket raporteve që vijnë nga dhuna në familje, ne si komitet me raportuar çdo 3 muaj dhe me pasur pikë diskutimi edhe numrin e dhunës familjare, kështu që mendoj se kjo është shumë e rëndësishme se, çdo tre muaj ke për të ju përkujtuar të gjithave subjekteve se sa u rrit numri i rasteve të dhunës familjare. Këto raporte të cilat na vijnë e që kanë të bëjnë me dhunën në familje, do të ishte më se e domosdoshme që t'i qesim në rendin e ditës të Kuvendit për diskutim dhe ne po tentojmë që raportimi para Kuvendit të jetë 3 herë në vit, kështu që të gjitha rekomandimet tona munden me qenë të rëndësishme me u prezantuar para Kuvendit.

Besart Krasniqi, tha se është më se i nevojshëm ky raportim, p.sh në këto “ 16 ditë aktivizim” ka ndodhur rasti i dhunës familjare me fatalitet vrasja e mësueses.

Violeta Salihu, sa i përket raportimit para Kuvendit për rastet e dhunë në familje do të ishte mirë që të kemi një koordinim edhe me znj. Adelina Sahiti, drejtore e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale.

Leunora Shabani-Bajraktari, lidhur me raportimin e rasteve të dhunës familjare në Kuvend , shprehi një pakënaqësi duke cekur se në mandatin e kaluar, unë si ish- anëtare e Kuvendit, më shumë ju kanë kushtuar rendësi rrugëve se sa çështjeve të tjera me karakter social etj.

Mbledhja përfundoi në ora 16:45

Procesmbajtësi
Zijadin Gashi

Kryesuesja e komitetit
Violeta Salihu



Faqe3nga3